



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 4228 Prot

Tiranë, më 8 / 09 / 2020

UDHËZIM

Nr. 21, datë 8 / 09 / 2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2365, DATË 26.11.2008
MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 277,
DATË 18.6.1997 "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT", I NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar dhe pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar:

U D H Ë Z O J :

1. Pikat 2/1 dhe 2.2 të Udhëzimit ndryshojnë si më poshtë:

"2.1. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor e dërgon atë brenda 24 orëve, me procesverbal/postë pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Mjeku i Shërbimit Social Shtetëror verifikon dosjet e paraqitura për vlerësim nëse janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMPV. Personi që vlerësohet për herë të parë, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMPV të nivelit të parë.

2.2. Rivlerësimi bëhet bazuar në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, pa praninë fizike të individit. KMPV në rastet kur nuk mund të marrë vendim vetëm bazuar në dokumentacionin e paraqitur për rivlerësim, ka të drejtë të thërrasë për t'u paraqitur fizikisht individin në komision. Paraqitja në KMPV do të bëhet në një nga mbledhjet e muajit pasardhës, por jo më vonë se 30 ditë nga data që do të realizohet vlerësimi me dosje. Njoftimi formal për paraqitje në KMPV do të bëhet përmes administratorit shoqëror të njësisë administrative, nën juridiksionin e të cilit ka vendbanimin personi."

2. Pika 16 e Udhëzimit, paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

Dokumentacioni i dosjes së përfituesit që është vlerësuar nga KMPV, hidhet në arkivën elektronike brenda afateve dhe sipas rregullave të detajuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe më pas dërgohet pranë njësisë administrative së bashku me njoftimin për vendimin për çdo person.”.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Institucionet Shëndetësore dhe njësitë e vetqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

BARDHYLKA KOSPIRI

